

Gjakova promovon varietete hibride



Të ngjajshëm

prevnext

•



Nga sot, gjakovarët paguajnë faturat e mbeturinave në Postë

•



KDI: Shpendi ngrit transparencën, Mimoza bie



Nora Gjakova sjellë të bronztën në Kosovë

- ### 3Shares

Tri varietet të reja hibride janë promovuar sot në Gjakovë, standard ky që po rezulton të jetë më kualitativ dhe më i suksesshëm. Në fushë të hapur u mbledhën sot fermerë të rajonit të Gjakovës dhe Rahovecit ku promovuan dhe diskutuan për këto varietete.

Promovimi u bë në kuadër të Ditës Fushore dhe Ditës së Eksportit, aktivitet ky që tashmë është bërë tradicional dhe organizohet nga qendra grumbulluese “Agrocelina” me seli në Xërxe.

Ishte kryetarja e komunës së Gjakovës Mimoza Kusari – Lila, u shpreh e kënaqur që produktet e Kosovës dita e ditës po rriten dhe po eksportohen edhe në vendet e tjera.

Kusari – Lila, tha se deri më tani nuk ka pasur një strategji të përgjithshme për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe se tokat janë lënë djerrinë në mungesë të kësaj strategjie.

Sipas saj Gjakova por edhe vendet tjera do të jenë të suksesshme atëherë kur ka një bujqësi të zhvilluar.

Kryetarja e Gjakovës shpreson se nga dita në ditë në tregun e Kosovës do të ketë sa më shumë produkte kosovare dhe të shfrytëzohet çdo pëllëmbë toke. Kjo, sipas saj ndihmon edhe në ngritjen e eksportit në vendet e zhvilluara.

Sipas Kusari – Lilës, vetëm të organizuar me bashkëpunim të qeverisë qendrore, kuvendit komunal dhe shoqatave mund të arrihet tek një bujqësi e zhvilluar.

Për promovimin e prodhimeve perimtare në Kosovë dhe shënimin e ditës së eksportit foli Fehim Rexhepi nga Qendra Grumbulluese “Agrocelina”. Ai, tha se varietetet hibride të cilat u promovuan sot janë më kualitative dhe me më pak kosto.

E shembullin e këtyre varieteteve hibride nuk pat kush ta tregoi më mirë se fermeri që tashmë ka të mbjella më shumë se 50 ari tokë.

Nexhat Lushi, tregon se me këtë puna i ka shkuar më mirë. Ai tha se varietetet hibride nuk mund të krahasohen me mbjelljen tradicionale. **/KosovaPress/**





...lajmi i plotë është në sistemin me parapagim.

- See more at: <http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/gjakova-promovon-varietete-hibride-49743/#sthash.4BFSsDZ7.dpuf>